

URDHËR
Nr. 441, datë 15.10.2021

PËR DISA SHTESA NË URDHRIN NR. 434, DATË 22.7.2020, “PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE MJEKËSORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË TË NIVELIT TË PARË DHE EPROR PËR VLERËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 4, pika 3 dhe nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar, pikave 2 dhe 7, të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 434, datë 22.7.2020, “Për miratimin e përbërjes së komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë të nivelit të parë dhe epror për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara”, bëhen shtesat si vijon:

1. Në pikën 1, germa “b”, komisioni “Onkologji/ortopedi/kirurgji/reumatologji”, pas pikës “iii” shtohet pika “iv” me këtë përmbajtje:

iv. Enton Bollano (mjek kirurg).

2. Në Pikën 1, germa “c”, komisioni “Paraplegji/tetraplegji/neurologji”, pas pikës “iii” shtohet pika “iv”, me këtë përmbajtje:

iv. Pavllo Diamanti (mjek neurolog).

3. Në pikën 1, pas germës “d” shtohet germa “e” me këtë përmbajtje:

e) Shëndeti mendor

i. Besmira Zenelaj (psikiatër);

ii. Valentina Asabella (psikiatër);

iii. Ilir Mica (psikiatër).

4. Në pikën 2, germa “a”, komisioni (KMCAP/KMPV) “Shëndeti mendor”, pas pikës “iv” shtohet pika “v”, me këtë përmbajtje:

iv. Ardian Braho (psikiatër)

5. Në pikën 2, germa “ç”, komisioni (KMCAP/KMPV) “Verbëri”, pas pikës “iii” shtohet pika “iv” dhe “v” me këtë përmbajtje:

iv. Ermal Simaku (okulist)

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu